

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **UA/2016-25-4007-1-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me pajisje Back-up për nevojat e KRPP-së**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

Panamic ICT L.L.C.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Bedri Berisha, Mati 1, C-2, Nr. 1

(Adresa)

Prishtinë

(Vendi)

10000

(Kodi postar)

+383 49242911

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Henor Kuqi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@panamic-ict.com

(Adresa elektronike)

03.07.2025

(Data e parashtrimit të kërkesës)

H.K.

(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Furnizim me pajisje Back-up për nevojat e KRPP-së**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 13.05.2025 ndërsa hapja publike është bërë në datën 04.06.2025.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 18.06.2025.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë, me datë 23.06.2025 iu kemi drejtuar AK-së me këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 26.06.2025 e refuzuar kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga ne, andaj të pakënaqur me vendimin e tillë po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderëve është bërë në datën 04.06.2025. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 13.05.2025 ndërsa hapja publike është bërë në datën 04.06.2025.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 18.06.2025.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë iu kemi drejtuar AK-së me këtë Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 26.06.2025 e refuzuar kërkesën për rishqyrtim të dorëzuar nga ne, andaj të pakënaqur me vendimin e tillë po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit si të barabartë. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK na ka konsideruar të përgjegjshëm duke na eliminuar nga konkurrenca edhe pse i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së përkatësisht të dosjes së tenderit që ishin përcaktuara paraprakisht nga vet AK-ja. Nga arsyetimi për eliminim që na ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij me kërkesat e dosjes së tenderit, shihet se ne jemi tenderues komplet i përgjegjshëm dhe se AK gjatë eliminimit tonë ka aplikuar kërkesa dhe kritere që nuk i ka pasur fare në dosjen e tenderit.

Pra AK ka aplikuar ligjin në mënyrë selektive kur na ka eliminuar për referenca të kompanisë dhe dëshmitë e ekspertit pasi që në kundërshtim të plotë me nenin 56 të LPP-së ka aplikuar edhe kritere të cilat nuk e ka pasur të përcaktuar paraprakisht në dosje të tenderit.

Nisur nga krejt kjo, po shihet hapur se evidentimi kinse i mangësive tek tenderi jonë konsiderohet diskriminim i madh ndaj tenderit tonë. Shtu këtu faktin që ne kemi qenë me çmim më të ulët për më shumë se 6.5% në krahasim me tenderuesin e shpallur fitues e që tregon se AK ka shkelur edhe nenin 1, 6 dhe 60 të LPP-së duke mos shfrytëzuar aspak mjetet/buxhetin e vet në mënyrë të drejtë dhe ekonomike.

Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së, kjo konsiderohet trajtim jo i barabartë i tenderuesve përkatësisht favorizim i plotë këtij OE dhe diskriminim ndaj neve e që njëherit konsiderohet shkelje e pastër e kësaj dispozite ligjore. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë

gjatë këtij procesi të vlerësimit si dhe për çdo mangësi të OE të shpallur fitues, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

2. AK ka shkelur nenin 56 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve ka aplikuar kritere apo elemente në kritere që nuk i ka pasur të përcaktuara tek dosje e tenderit. Dihet mirë se paragrafi 3 i këtij neni e përcakton qartë se (*citoj*):

Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Aplikimi i kriterit kinse nuk kemi referenca në sisteme back-up nuk qëndron fare sepse kërkesa ishte për furnizime të ngjashme e që i bie se çdo furnizim me sisteme apo pajisje të Teknologjisë Informative e plotëson kushtin e kërkuar. Vet KRPP e ka dhënë opinionin adekuat të cilin e ka publikuar edhe tek web faqja e tyre ku ka sqaruar se në rastet e tilla duhet që detyrimisht të shikohet **Kodi i Fjalorit të Përbashkët të Prokurimeve (FPP)** e që në rastin tonë përputhen plotësisht me të dhënat e tilla të procedurës së prokurimit për të cilën kemi aplikuar. Përpos kësaj shihet se AK ka aplikuar kriter shtesë edhe tek kërkesa për përvojën e ekspertit, ku më mirë të themi e ka keq aplikuar termin “**organizatë**” pa e sqarua në dosje se çka ka menduar të thotë me termin e tillë. Pra askund tek kërkesa nuk është treguar çka është menduar me termin “organizatë” ndërsa gjatë vlerësimit po e aplikon atë për kinse ka menduar për organizatat qeveritare apo ndërmarrjet e mëdha publike etj. Edhe ky aplikim bie plotësisht ndesh me nenin 56.3 të LPP-së dhe se arsyetimi i AK-së për eliminim del të jetë komplet **i pabazuar**.

Pra sipas krejt kësaj po shihet se aplikimi i kritereve shtesë që nuk i kishte fare në dosje të tenderit, e shtynjë AK-në në shkelje të plotë të nenit 56.3 të LPP-së.

Vlen të thuhet edhe kjo se sipas ligjeve mbi organizimin e kompanive tregtare dhe shoqërore, çdo kompani pavarësisht se a është e shtetit apo private, të njëjtat janë dhe mund të quhen edhe “organizata” pavarësisht madhësisë së tyre dhe se termi organizatë nuk e përcakton detyrimisht madhësinë e kompanive apo institucioneve, etj.

Detalisht këto shkelje dhe këtë mos respektim të kritereve nga ana e AK-së do të i shpalosim tek pretendimi mbi shkeljen e nenit 59 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kërkesat dhe kriteret e veta nga dosja e tenderit si dhe ka shtuar kritere shtesë me rastin e eliminimit tonë nga konkurrenca.

Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se:

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

E themi këtë sepse ashtu siç e sqaruam edhe tek pretendimi i kaluar shihet se AK na ka eliminuar neve për kritere e kërkesa që nuk i kishte fare tek dosja e tenderit dhe duke i keq aplikuar disa nga to që ishin paraqitur si gjysmake.

Arsyeja e eliminimit të tenderit tonë duket kështu:

Mbështetur në vlerësimin e bërë nga ana e ekspertëve të komisionit të vlerësimit të ofertave ju nuk keni plotësuar;
 Nga te dhënat e prezantuar ne oferte si dëshmi/evidence te përmbushjes se kërkesës 1, ofertuesi ka paraqitur dokumentin/listën e kontratave te emërtuar „Lista e kontratave – Furnizim me TI“, si dhe katër dokumente me dëshmi mbi referencat për kontratat përkatëse.
 Nga këto te dhëna nuk ofrohet dëshmi e qartë për kontrata për furnizime te ngjashme me furnizimin e kërkuar ne këtë aktivitet te prokurimit, apo asnjë furnizim nuk është për back-up te ngjashme siç mund te jene NAS (Network Attached Storage), DAS (Direct Attached Storage), softuer për back-up, etj
 Gjithashtu për kërkesën nr. 2, ju keni paraqitur dokumentin me emërtimin „Certifikimet.pdf“i cili përmban një marrëveshje angazhimi me z. B.K si ing i infrastrukturës – backup dhe certifikimet e z. B.G si Synology DSM Architect.
 Certifikimi i dorëzuar për Z. G nuk plotëson kriterin në nivel të organizatave, është certifikim për produktet në nivel të bizneseve të vogla.
 Gjithashtu nuk keni dëshmuar që ka përvojë ne zgjidhje „backup to tape“ te të dhënave nga sisteme te TI ne nivel te organizatave. sipas kërkesës nr. 2 tek kapaciteti teknik profesional.
 Duke u bazuar ne te dhënat e lartcekura oferta e juaj konsiderohet si oferte e papërgjegjshme.

Arsyetimi i parë shihet se është komplet i pa bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit andaj si i tillë konsiderojmë se është edhe i pabazuar në ligj. Para se ta argumentojmë më në detale, po e paraqesim fillimisht se si dukej kërkesa e dosje së tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 1 – Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses se paku një kontratë me furnizime të ngjashme gjatë tri viteve të shkuara deri në publikimin e njoftimit për kontratë.	Dëshmia e kërkuar dokumentare: Evidenca 1- Kur furnizimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi duhet te dorëzohet certifikata e pranimi ose referenca të lëshuar nga autoriteti i tillë. Kur furnizimet janë kryer për një blerës privat, pranohet kopja e çdo dokumenti që është i nënshkruar nga blerësi dhe kryerësi i furnizimeve.
---	-----------	--	---

Sipas kërkesës dhe asaj që ne e kemi ofruar shihet se furnizimet tona janë plotësisht të ngjashme me ato që ka kërkuar AK-ja. Aplikimi i kriterit që furnizimet do duhej të ishin për NAS (Network Attached Storage), DAS (Direct Attached Storage), Software për back-up etj. konsiderojmë se janë kritere që nuk ishin të cekura fare tek kriteri i kërkuar në dosje të tenderit andaj përpos që nuk mund të aplikohen sipas nenit 59 të LPP-së, nuk mund të aplikohen as sipas nenit 56.3 të LPP-së. Aplikimin e pa drejtë të këtij kriteri e argumenton dhe e vërteton edhe vet AK përmes sqarimit tek refuzimit të Kërkesës për Rishqyrtim, kur e thotë (citoj):

Pra, nuk është kërkuar që furnizimi apo kontratat të jenë të njëjta me furnizimin e kërkuar **Back-up to tape** (e cila kërkesë do të kufizonte ofertimin), por mund të jenë backup to disk, apo NAS, DAS, etj që janë të ngjashme në natyrë, karakteristika, kompleksitet, etj.

Sipas kësaj, edhe pse AK po thekson qartë se nuk kanë kërkuar që furnizime apo kontratat të jenë të njëjta me furnizimet e kërkuara, prap po e aplikojnë si kriter të tillë sepse detyrimisht po kërkojnë që referencat apo kontratat e realizuara të jenë Back-up për NAS, DAS etj, që ligjërisht është e ndaluar. Edhe atë që AK e ka thënë dhe kontestuar lidhur me shembullin për “mollët”, është e padrejtë dhe aspak profesionale sepse nuk e kemi thënë ne atë por e ka thënë vet KRPP në interpretimin e sajë. Të kundërshtoj interpretimin e institucioni të vetëm kompetent për interpretime të tilla, duhet të jetë diçka jo e natyrshme! Nisur nga tha u tha më lartë dhe kur të shikohen me kujdesë projektet tona të realizuara, shihet se të gjitha furnizimet që ne i kemi paraqitur janë të ngjashme me furnizimet e kërkuara dhe si të tilla edhe duhet të pranohen. Nëse AK ka menduar që si referenca të ngjashme pranohen vetëm ato për Back-up to tape, NAS DAS etj, atëherë është dashur ta potencoj tek kërkesa e jo tash gjatë vlerësimit ta përcaktoj sipas interesave të veta nivelin e ngjashmërisë së referencave që do të pranohen. Pavarësisht kësaj, me që tek lista e projekteve të realizuara që ne e kemi paraqitur, shihet se në furnizimet e tilla ka edhe sisteme back-up si dhe software për back-up dhe me që në kërkesë nuk ka qenë e përcaktuar fare niveli i ngjashmërisë së referencave, tregon qartë se ne e kemi plotësuar kriterin e kërkuar nga AK-ja. Pra mjafton të shihni kontratat me Komunën e Prizrenit dhe ato me Komunën e Suharekës dhe do të bindeni edhe vet se si të tilla e plotësojnë kriterin e vendosur tek dosja e tenderit por edhe kriterin **shitesë** të aplikuar nga AK për back-up dhe software për back-up i cili nuk që nuk ishte fare tek kërkesa e FDT-së. Si do që të jetë, po që se e lexoni me kujdesë edhe opinionin e KRPP-së, atëherë do të bindeni që shumica e projekteve tona të paraqitura në listë e plotësojnë kërkesën e dosje së tenderit. Ja si duket ky opinion i cili ndodhet i publikuar edhe në web faqen e KRPP-së (*përfshi edhe shembullin e projekteve me mollë*):

Me që në LPP, saktësisht në nenin 4 (Përkufizimet) të këtij ligji dhe as me legjislacionin dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve që i janë dhënë me këtë ligj nuk jepet ndonjë përkufizim i termeve "të njëjta" dhe "të ngjashme", megjithatë konform nenit 87, paragrafit 2, nën paragrafit 2.2 të LPP-së, KRPP ofron këtë:

OPINION

Termi "njëjtë (i, e)" mbiemër që ka kuptimin po ai, ose po ajo gjë. Shembull: i njëjti send, i njëjti vend, e njëjta ngjyrë etj.

Termi "ngjashëm (i, e)" mbiemër, ka kuptimin që ngjan shumë me një tjetër. Shembull: në raste (në rrethana) të ngjashme.

Në kuptim të prokurimit publik: Termi "njëjtë (i, e)" ka kuptimin e një furnizimi, shërbimi a pune të njëjtë (identike) me atë që kërkohet dhe/ose lëndën e kontratës.

Termi "të ngjashme" ka kuptimin e furnizime, shërbimeve, punëve të ngjashme me atë që kërkohet në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Shembull: Lënda e Kontratës “Furnizim me mollë”. Nëse AK kërkon si dëshmi “Listën e Kontratave të furnizimeve të njëjta gjatë tri viteve të fundit nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë në vlerë prej minimum.....euro”. Kjo duhet të nënkuptoj se OE duhet të sjellë listën e kontratave të furnizimeve me mollë në vlerën e specifikuar dhe i përjashton OE nga pjesëmarrja që kanë kryer furnizime me pemë dhe/ose perime të tjera. Prandaj një kërkesë e tillë e kufizon maksimalisht konkurrencën dhe i diskriminon operatorët ekonomik potencial (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 7 të LPP-së).

Në LPP, specifikisht në nenin 69 lidhur me kapacitetet teknike dhe/ose profesionale, referenca përkthehet si në vijim: “Listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara.....” Pra, nuk përmendet asnjëri nga termet “të njëjta” apo “të ngjashme”.

Pavarësisht nga kjo, çdo herë në çdo fazë të aktivitetit të prokurimit AK-të duhet t’i respektojnë parimet themelore të prokurimit publik (transparenca, konkurrenca e lirë, trajtimi i barabartë jo diskriminimi). Prandaj AK-të nuk duhet të specifikojnë kritere të përzgjedhjes me të cilat e kufizojnë konkurrencën dhe i diskriminojnë operatorët ekonomik potencial dhe kështu të mos mund të arrihet vlera për para.

Sa i përket pyetjes së parashtruar nga AK se: “Cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme...?, KRPP nuk mund të tejkalojë autorizimet që i janë dhënë me ligj dhe të përcaktoj se cilat furnizime, shërbime apo punë konsiderohen të ngjashme me lëndën e kontratës së specifikuar nga AK në Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Një përcaktim i tillë është kompetencë ekskluzive e AK-së. Pra Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit me ndihmën e njësisë së kërkesës dhe/ose ekspertëve të kësaj fushe mund të përcaktojnë shërbimet e ngjashme. Në këtë rast si orientim i mirë për përcaktimin e furnizimeve, shërbimeve apo punëve të ngjashme mund të shërbejnë edhe kodet e përcaktuara në FPP ku aktualisht janë të publikuara 8.323 kode të FPP në Platformën Elektronike të Prokurimit Publik.

Bazuar në krejt këtë dhe bazuar në mënyrën si e ka përshkruar kërkesën vet AK-ja, del që shumica e kontratave të realizuara nga ne e plotësojnë kushtin për tu pranuar si të rregullta, andaj aplikimi i tillë i arsytimit për eliminim nga ana e AK-së është plotësisht i pabazuar dhe në kundërshtim të plotë me nenin 59 të LPP-së.

Arsyetimi i dytë shihet gjithë ashtu se është i pa bazuar në kërkesën e dosjes së tenderit andaj si i tillë konsiderojmë se është i pabazuar edhe në ligj. Para se ta argumentojmë më në detale, po e paraqesim fillimisht se si dukej kërkesa e dosje së tenderit:

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional Kërkesa 2- Ofertuesi duhet të propozojë se paku një ekspert të certifikuar në softuere për backup, përvojë të deshmuar në zgjidhje „backup to tape” të të dhënave nga sisteme të TI në nivel të <u>organizatave</u>.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Evidenca 2- Çertifikatë që dëshmon kualifikimin e tillë, si dhe së paku një reference që dëshmon realizimin e një projekti të ngjashëm
---	-----------	---	--

Si përgjigje ndaj kësaj kërkesë ne kemi paraqitur një profesionist/ekspert të fushës së kërkuar i cili posedon certifikimin dhe përvojën e kërkuar në kërkesën e AK-së. Keq aplikimi i kriterit që gjoja eksperti në fjalë nuk e ka përvojën dhe certifikimin në nivel të organizatave, aq sa është i jashtëligjshëm është edhe i pakuptimtë sepse kërkesa e ka cekur vetëm termin organizatë duke mos sqaruar asnjë gjë më shumë. Bazuar në ligjin për shoqëritë tregtare del që edhe kompanitë private, edhe OJQ-të edhe OSHC-të përfshi këtu edhe shoqëritë aksionare private dhe ato shtetërore, ndërmarrjet shtetërore qendrore, ndërmarrjet shtetërore lokale, si dhe ndërmarrjet private, për nga organizimi janë dhe cilësohen si **organizata**. Pra termi organizatë nuk e përcakton e as determinon madhësinë e kompanive. Nisur nga kjo del që ky arsyetim i AK-së për eliminim është komplet i pa bazuar sepse në certifikimet të tilla e as dëshmitë mbi përvoja, nuk ceket askund madhësia e kompanisë përkatësisht punëdhënësit për të cilin ka punuar ndonjë ekspert.

Këtu vlen të thuhet edhe kjo se as ekspertët e OE që AK e ka shpallur fitues nuk kanë ndonjë dëshmi që tregon se a janë të certifikuar për **“organizata”** apo për kompani private. Thjesht, certifikimi është certifikim dhe nuk ka ndonjë ndalesë apo kusht se për cilin lloj të kompanive apo organizatave mundet të aplikohet dhe përdoret. Rrjedhimisht nga e tërë kjo del që arsyetimi AK-së për eliminimin tonë përpos që është selektiv dhe që bie në kundërshtim të plotë me nenin 7 të LPP-së, është edhe tendencioz dhe komplet i pabazuar pasi që është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 56.3 dhe 59.4 të LPP-së. Edhe arsyetimi i dhënë nga AK tek refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim është komplet i pakuptimtë pasi që AK nuk ka kompetencë të komentoj dhe interpretoj llojet e certifikimeve. Certifikimi që ne kemi paraqitur është gjithë përfshirës dhe e mbulon edhe pjesën për Back-up-it në çfarëdo niveli të kompanive për nga madhësia, përfshi edhe **“organizatat”** që po e potencon AK edhe pse nuk e ka përcaktuar paraprakisht se çka ka menduar me atë fjalë, andaj konsiderojmë se edhe kriteri i tillë është plotësuar nga ne që të konsiderohemi si OE të përgjegjshëm.

Nga e tërë kjo që u potencua, argumentua dhe u faktua nga ne, po shihet se AK ka shkelur plotësisht nenin 59 të LPP-së gjatë vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve andaj e lusim ekspertin shqyrtues që të merr për bazë të gjitha faktet dhe argumentet e dhëna nga ne, për çka besojmë se do të i ndihmojnë dhe do ta bindin që pretendimet tona janë të bazuara.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vlersuar drejt sipas kriterit të paraqitur në dosje të tenderit. Me që shihet se ne jemi tenderues i përgjegjshëm dhe kemi edhe çmimin më të ulët në krahasim me konkurrencën, i bie se AK

përpos që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit, nuk ka respektuar as kriterin e vlerësimit që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Krejt kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK pa të drejtë na ka eliminuar nga konkurrenca e mëtutjeshme me arsyetime të pabazuara dhe të paligjshme. Mos respektimi i neneve tjera siç është neni 7, 56 dhe 59 i LPP-së siç sqaruam më sipër, e shtynë AK-në edhe drejt shkeljes së plotë të nenit 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së pasi që nuk ka respektuar kërkesat e dosjes së tenderit të vendosura në përputhje me nevojat veta. AK ka vendosur vet kërkesa për përshtatshmërinë profesionale dhe teknike që lidheshin me nenin 69 të LPP-së por që gjatë vlerësimit nuk i ka zbatuar ato si duhet dhe siç i ka përshkruar në dosjen e tenderit. Pra përpos që kemi të bëjmë me mos aplikim të drejtë të kriterëve të dosjes dhe kërkesave të nenit 69 të LPP-së të përcaktuara tek kërkesat e FDT-së, kemi të bëjmë edhe me diskriminim të OE siç jemi ne në këtë rast.

6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime nga ne edhe pse po shihet se shumë elemente për të cilat na ka eliminuar i ka pasur të paqarta. Mos aplikimi i qëllimshëm i nenit 72 të LPP-së për sqarim të tenderit tonë sidomos lidhur me natyrën projekteve të realizuara si dhe për certifikimet e ekspertit tonë, e shtynë AK-në drejt shkeljes së plotë të këtij nenin dhe të parimeve të mira të prokurimit që do duhej aplikoheshin gjatë vlerësimit, sqarimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pra mos kërkesa e sqarimeve nga ne, përpos që konsiderohet shkelje e nenit 7 të LPP-së, konsiderohet edhe aplikim selektiv i mundësisë për sqarim dhe shkelje e plotë e nenit 72 të LPP-së.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga tërë ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e OE “Panamic ICT L.L.C.” lidhur me tenderin “Furnizim me pajisje Back-up për nevojat e KRPP-së” i iniciuar nga **AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK - **AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim**.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit e sidomos Kërkesave mbi mundësit teknike dhe profesionale, ku realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallej OE “Panamic ICT L.L.C.”.











9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme përfshi ato në fushën financiare, fitime të munguara dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Kontrat
-  2 Dosja e tenderit-shqip
-  3 Përshkrimi i cmimit
-  4 Sqarime Shtesë - Furnizim me pajisje Back-up... 20.05.2025
-  5 Procesverbali i hapjes se tenderit
-  6 Njoftim mbi vendimin
-  7 Lista e kontratave - Furnizim me pajisje te TI - PANAMIC
-  8 Certifikimet B. Kelmendi
-  9 KERKESE PER RISHQYRTIM - AQP - PANAMIC ICT LLC 23.06.2025
-  10 Refuzimi i kerkesës për ri-shqyrtim 26.06.2025

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*